



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË
TIRANË

Nr. 4996/1 Prot.

Tiranë, më 13.04.2023

Lënda: Kthim përgjigje

Drejtuar: Qendra "Res Publica", përfaqësuar nga Z. Dorian Matlija

Adresa: Blv "Gjergj Fishta", Nd.24, H.3, Ap.7, Tiranë

Në përgjigje të shkresës Tuaj "Kërkesë për informacion" ardhur në email-in zyrtar më datë 05.04.2023, protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 4996 prot. datë 13.04.2023, bashkëlidhur po Ju dërgojmë urdhërin nr. 44 datë 01.06.2022 " Për marrjen e masave për respektimin e solemnitetit të gjykimit " të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë .

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

ZV/KRYETARE E GJYKATËS
ELIANA ÇIÇOLLI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË
TIRANË

Nr. 3345 Prot

Tiranë më 01.06.2022

URDHËR

Nr. 44 datë 01.06.2022

“Për marrjen e masave për respektimin e solemnitetit të gjykimit”

Në Tiranë, sot në date 01.06.2022, unë Elvana Çiçolli Zëvendës Kryetare e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në bazë të neneve 26-28 dhe 37 të Ligjit Nr. 98, datë 06.11.2016 “Për Organizimin e pushtetit gjyqësor”, Kodin e Etikes Gjyqësore miratuar me vendimin nr 171 date 22.04.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ,

URDHËROJ:

1. Të gjithë palët ndërgjyqëse, përfaqësuesit ligjorë, dëshmitarë ekspertë dhe çdo përdorues tjetër që paraqitet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me qëllim pjesëmarrjen në seancat gjyqësore dorëzojnë në katin e parë aparatet telefonikë.
2. Aparatet telefonikë mbahen në ruajtje deri në përfundim të seancës gjyqësore në dollapet e vendosur në hyrje të gjykatës monitoruar nga punonjësit e gjykatës dhe sistemi I kamerave.
3. Të gjithë palët ndërgjyqëse, përfaqësuesit ligjorë, dëshmitarë, ekspertë dhe çdo përdorues tjetër që paraqitet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me qëllim pjesëmarrjen në seancat gjyqësore të respektojnë rregullat e etikës formale përsa I përket veshjes së përdorur.
4. Personave që nuk zbatojnë parashikimet e mësipërme nuk u lejohej hyrja në ambientet e brendshme të gjykatës në respektim të solemnitetit të gjykimit.
5. Një kopje e urdhërit të arkivohet dhe një kopje t’u shpërndahet gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Një kopje e urdhërit afishohet në ambientet e hyrjes së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe një kopje publikohet në faqen zyrtare të web.



6. Ngarkohet Z.Sabah Mera për zbatimin e këtij urdhri.
7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë më datë 01.06.2022.

Zëvendës Kryetare e Gjykatës

ELVANA ÇIÇOLLI

